

Pyetësor

Drejtësia kushtetuese: Funkcionet dhe raportet me autoritetet e tjera publike

I. – Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Parlamentin dhe Qeverinë

1. Roli i Parlamentit (ose sipas rastit, Qeverisë) në procedurën e emërimit të gjyqtarëve në gjykatën kushtetuese. Pas emërimit, a mund të hiqen gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nga i njëjti autoritet? Cilat mund të jenë bazat/arsyet për një largim të tillë?

Neni 125 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 7 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikon se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

Sipas neni 128 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 10 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” pas emërimit të tij Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore apo fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Procedura e shqyrtimit të Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për një nga shkaqet e parashikuara më sipër fillon me kërkesë të motivuar të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

2. Deri në çfarë mase gjykata kushtetuese ka autonomi financiare – në hartimin dhe administrimin e shpenzimeve të saj buxhetore?

Nenet 3 dhe 6 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikojnë se Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë financiare. Ajo harton dhe administron vetë buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

3. A është e zakonshme apo e mundur që Parlamenti të ndryshojë ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese, pa u konsultuar më parë me këtë gjykatë?

Ligji nr. 8577, dt. 10.02.2000 Për organizimin dhe funksionimin e GJK është miratuar me konsulencën e GJK dhe të ekspertëve të Komisionit të Venecias. Parlamenti, normalisht konsultohet me subjektet e interesuara përpara miratimit të një ligjit.

4. A ka gjykata kushtetuese kompetencën për të kontrolluar kushtetutshmërinë e rregulloreve të Parlamentit dhe respektivisht Qeverisë?

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në shumë vendime të saj është shprehur se Rregullorja e Kuvendit është një akt që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, që përcaktojnë rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese. Pra, Rregullorja, mund të jetë vetëm objekt i kontrollit kushtetues në rastet kur dispozita të nivelit kushtetues, të përfshira në të, janë të papajtueshme me Kushtetutën (shih vendimin n. 29/2009).

Edhe në vendimin n. 33/2010 të Gjykatës Kushtetuese theksohet se Rregullorja e Kuvendit mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të. Për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt i një kontrolli të tillë.

5. Kontrolli kushtetues: specifikoni llojet / kategoritë e akteve ligjore në bazë të të cilave bëhet ky kontroll).

Njihen dy forma kontrolli: paraprak ose *a priori* dhe kontroll represiv ose *a posteriori* dhe natyra e tyre i karakterizon ato në abstrakt dhe konkret. Kontrolli paraprak ushtrohet përpara se aktet të kenë hyrë në fuqi. Kjo dallon nga shqyrtimi paraprak që i bën GjK kërkesave që merr në shqyrtim ajo. GjK ushtron kontroll *a priori*, kur shqyrton pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre në Kuvend, si dhe kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum.

Kontrolli *represiv* ushtrohet ndaj atyre akteve që kanë hyrë tashmë në fuqi dhe kanë sjellë efekte. Objekt i këtij kontrolli janë të gjitha kategoritë e normave të rendit të brendshëm juridik: ligjet, rregullat e procedurës parlamentare, dekretet, aktet e tjera me fuqinë e ligjit, aktet normative të organeve qendrore dhe të qeverisjes vendore. Ky kontroll mund të jetë *abstrakt dhe konkret*. I pari shtrihet ndaj ligjit, akteve normative të organeve qendrore dhe vendore si dhe akteve të tjera që kanë fuqinë e ligjit. Efektet e vendimeve të GjK për këto raste janë *erga omnes* – për të gjithë. Kontrolli konkret inicohet nga gjykatat e sistemit të zakonshëm gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, kur gjyqtari ka dyshime për kushtetutshmërinë e normës që duhet zbatuar. Në këtë rast gjyqtari e pezullon çështjen dhe ia dërgon shqyrtimin e kushtetutshmërisë së normës GjK. Ky kontroll konsiderohet konkret sepse lidhet direkt me çështjen konkrete që shqyrton gjykata e zakonshme.

6. a. Parlamenti dhe Qeveria, sipas rastit, veprojnë pa vonesa për të ndryshuar ligjin (apo një akt tjetër të shpallur si antikushtetues) në mënyrë që ai të jetë në përputhje me Kushtetutën, duke zbatuar vendimin e gjykatës kushtetuese. Nëse kjo gjë është kështu, cili është afati i përcaktuar në këtë rast? A ekziston ndonjë procedurë e posaçme? Nëse jo, specifikoni alternativat. Jepni shembuj.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndonjë afat të përcaktuar në ndryshimin e ndonjë ligji a akti tjetër të shpallur si antikushtetues nga një vendim i GjK. Neni 87 i Rregullores së

Kuvendit parashikon se Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

6.b. Parlamenti mund të shfuqizojë vendimet e gjykatës kushtetuese: specifikoni kushtet.

Në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare.

Kundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk pranohet asnjë kundërshtim. Pra, ato janë përfundimtare. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit, konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet (neni 75 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese). Parishikueshmëria dhe pakundërshtueshmëria e vendimeve (në veçanti të pranimit) lidhet me karakterin e tyre të detyrueshëm dhe përfundimtar.

7. A ekzistojnë mekanizma bashkëpunimi të institucionalizuar midis Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të tjera? Nëse po, cila është natyra e këtyre kontakteve / cilat funksione apo kompetenca dalin në pah?

Jo, nuk ka.

II. – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve organike nga Gjykata Kushtetuese

1. Cilat janë veçoritë karakteristike të mosmarrëveshjeve organike (mosmarrëveshjet ligjore me natyrë kushtetuese midis autoriteteve publike)?

Mosmarrëveshjet ligjore me natyrë kushtetuese mund të lindin:

- a) ndërmjet organeve të pushtetit shtetëror (në rrafsh horizontal ose vertikal) – mosmarrëveshje kompetencash;
- b) ndërmjet organeve që i përkasin juridiksioneve të ndryshme gjyqësore (konflikte të juridiksionit);
- c) ndërmjet organeve që i përkasin të njëjtit pushtet p.sh. ndërmjet dy ministrave (konflikte të kompetencave).

2. Specifikoni rastet kur gjykata kushtetuese është kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve.

Në juridiksionin kushtetues përfshihet vetëm zgjidhja e dy llojeve të mosmarrëveshjeve së kompetencave:

- a) mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes së pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) që diktohet nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve;

b) mosmarrëveshjet e kompetencave në rrafsh vertikal (pushtetit qendror - qeverisje vendore)

Kusht i domosdoshëm është që mosmarrëveshja të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së këtyre pushteteve. Një mosmarrëveshje kompetence përfshihet në juridiksionin kushtetues kur ajo lind ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme dhe secili prej tyre kërkon, veçmas tjetrit të shfaq vullnetin e pushtetit, nëpërmjet nxjerrjes së akteve.

3. Cili autoritet publik mund të përfshihet në këto mosmarrëveshje?

Është pranuar në jurisprudencën kushtetuese shqiptare se mosmarrëveshja e kompetencave mund të lindë:

a) mes të gjitha organeve kushtetuese;

b) ndërmjet organesh apo subjektsh që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të përcaktuar në këtë ose atë pushtet, si p.sh. *prokuroria nga njëra anë dhe parlamenti nga ana tjetër*;

c) ndërmjet organit kushtetues nga njëra anë dhe një pjese të organit kushtetues nga ana tjetër, si p.sh. *jo më pak se një e katërta e deputetëve dhe parlamentit* (shih vendimin n. 20/2007 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë).

4. Aktet ligjore, faktet apo veprimet që mund të sjellin këto mosmarrëveshje: a lidhen ato vetëm me mosmarrëveshjet mbi kompetencën apo përfshijnë dhe rastet kur një autoritet publik kundërshton kushtetutshmërinë e një akti të nxjerrë nga një autoritet tjetër publik? Në rast se gjykata juaj kushtetuese është shprehur mbi këto mosmarrëveshje, ju lutem të jepni shembuj.

Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrtton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Në vendimin n. 20, datë 04.05.2007, Gjykata Kushtetuese duke e cilësuar të drejtën e pakicës parlamentare (1/4 e deputetëve) për ngritjen e një komisioni hetimor si “kompetencë kushtetuese”, konstatoi se vendimi refuzues i parlamentit për mosngritjen e këtij komisioni, kishte shkaktuar lindjen e një mosmarrëveshje kompetence. Për rrjedhojë, ajo vendosi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet një të katërtës së deputetëve, nga njëra anë dhe parlamentit nga ana tjetër, duke shfuqizuar si antikushtetues shkaku e lindjes së konfliktit – *vendimin e parlamentit*.

Në vendimin n. 22, datë 05.05.2010, Gjykata Kushtetuese konstatoi se nga mënyra se si është përcaktuar objekti i hetimit parlamentar në vendimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor, me hetimin e kryer nga ana e komisionit hetimor, si dhe me konstatimin si të

paligjshëm të vendimeve të KRRT-së nga ana e këtij komisioni, është shkaktuar një konflikt kompetencash, duke sjellë si pasojë pengimin e ushtrimit të kompetencave të veta nga ana e kërkuarit Bashkia Tiranë. Kështu Gjykata vendosi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke shfuqizuar vendimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit Hetimor” dhe “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor”.

5. Kush ka të drejtën e inicimit të procedurave para gjykatës kushtetuese për këto mosmarrëveshje?

Ligji organik për Gjykatën Kushtetuese ka përcaktuar se kërkesa para Gjykatës Kushtetuese për gjykime të këtij karakteri ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se çdo organ pushteti legjitimohet të bëjë kërkesë kur pretendon se ndodhet përpara një konflikti kompetence, i cili mund të ketë lindur për shkak të ligjit ose të një veprimtarie faktike. Përcaktuese është që sfera e kompetencave e organeve apo subjekteve të konfliktuara duhet të jetë e përkufizuar nga norma kushtetuese.

6. Cila është procedura që zbatohet për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve?

Kërkesa për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

7. Cilat janë alternativat e gjykatës kushtetuese në nxjerrjen e vendimit të saj? Shembuj.

Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit. Pra gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe eliminuar dhe shkakun determinant që e ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes – pra normën antikushtetuese.

Përveç shembujve të mësipërm, me vendimin n. 29, datë 21.12.2006, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore kishte lindur një mosmarrëveshje kompetence për shkak se ligji përcaktonte një lloj dualiteti ndërmjet tyre për ushtrimin e kompetencave në fushën e planifikimit urban dhe të kontrollit mbi territorin. Pra, nga ekzistenca e një situatë të tillë ligjore, që kishte sjellë edhe një situatë faktike konfliktuale rezultonte se baza dhe shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet

pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, ishin normat ligjore, të materializuara në aktet përkatëse zbatuese. Detyrë e Gjykatës kushtetuese ishte të zgjidhte konfliktin ndërmjet tyre, duke konstatuar dhe evituar shkakun kryesor nga i cili kishte lindur mosmarrëveshja (shpalljen e ligjit si antikushtetues), si dhe të përcaktonte organin përkatës shtetëror që kishte në kompetencë zgjidhjen e çështjeve, objekt të mosmarrëveshjes.

8. Mënyrat dhe mjetet e zbatimit të vendimeve të gjykatës kushtetuese: veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike më vonë. Shembuj.

Sipas nenit 72/7 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.

Neni 81 i ligjit nr. 8577, datë: 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikon mjetet që sigurojnë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

III. – Zbatimi i vendimeve të gjykatës kushtetuese

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë:

- a) përfundimtare;
- b) i nënshtrohen apelimit; nëse po, ju lutem specifikoni cilat janë organet/subjektet ligjore që mund të bëjnë këtë apelim, afatet dhe procedura;
- c) me efekte detyruese *erga omnes*;
- d) me efekte detyruese *inter partes litigantes*.

Vendimet e Gjykatës janë përfundimtare, ato nuk i nënshtrohen asnjë lloj apelimi. Ato mund të kenë efekte detyruese *erga omnes* ose *inter partes litigantes*.

2. Lidhur me publikimin e vendimit në Gazetën/Fletoren Zyrtare, teksti ligjor i deklaruar antikushtetues do të:

- a) shfuqizohet;
- b) pezullohet deri në momentin që ligji/akti i deklaruar antikushtetues të jetë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës;
- c) pezullohet derisa ligjvënësi të ketë shpallur të pavlefshëm vendimin e shpallur nga gjykata kushtetuese
- d) raste të tjera.

Në momentin e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Fletoren Zyrtare teksti ligjor i deklaruar antikushtetues shfuqizohet.

3. Në rastet kur gjykata kushtetuese shpall antikushtetutshmërinë e një vendimi, cila është mënyra që ky vendim të bëhet detyrues për gjykatën përkatëse apo gjykatat e tjera?

Sipas nenit 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga çasti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i të cilës është shfuqizuar.

4. A është e zakonshme që ligjvënësi të përmbushë, brenda një afati kohor të caktuar, detyrimin kushtetues për të eliminuar çdo aspekt antikushtetues të konstatuar, si rezultat i kontrollit a posteriori dhe/ose a priori?

Sipas nenit 78 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj. Nuk parashikohet ndonjë afat kohor.

5. Çfarë ndodh nëse ligjvënësi nuk ka arritur të eliminojë të metat antikushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga Kushtetuta dhe/ose legjislati? Jepni shembuj.

6. A i lejohet ligjvënësit të miratojë sërish, nëpërmjet një akti tjetër normative, të njëjtën zgjidhje ligjore që është deklaruar antikushtetuese? Përmendnin gjithashtu argumentet përkatëse.

7. A mundet gjykata kushtetuese të ngarkojë organet e tjera shtetërore me zbatimin e vendimeve të saj dhe/ose të përcaktojë mënyrën se si do të zbatohen ato në raste të caktuara?

Neni 81 i ligjit nr. 8577, datë: 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton, se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Ky nen (neni 81), synon të vendosë rregulla të prera në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke shkuar deri aty sa Kryetari të Gjykatës Kushtetuese i jepet e drejta që të gjobisë personat që pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur ky vendim është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.